



Datë: 01.08.2025
Numër Protokolli: 5211/2025

A.nr.1255/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje: Malsore Gashi-Bajraktari, kryetare, Arben Mehmeti dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Avdyl Bekteshi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.1255/2025, të datës 01.07.2025, të parashtruar nga ankuesja F.Zh, kundër organit të punësimit: MPB, në çështjen juridike “*kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 01.08.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.1255/2025, e datës 01.07.2025, e parashtruar nga ankuesja F.Zh.

II. Mbetet në fuqi Njoftimi me numër protokolli 1154, i datës 20.06.2025, i Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore i Ministrisë së Punëve të Brendshme për shpalljen e rezultatit përfundimtar dhe Njoftimi nga Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore i Ministrisë së Punëve të Brendshme, për refuzimin e aplikacionit të ankuses, lidhur me konkursin me Nr. Reference RN00017620 për pozitën Asistent Administrativ

A r s y e t i m

Kandidatja për pranim në shërbimin civil, F.Zh (në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesi), me datë 26.06.2025, përmes postës ka parashtruar ankesë për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e cila është pranuar më datë 01.07.2025, kundër refuzimit të aplikacionit lidhur me konkursin me Nr. Reference RN00017620 për Grupin e Administrimit të Përgjithshëm për pozitën *Asistent Administrativ* i shpallur nga Ministria e Punëve të Brendshme.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datën 10.07.2025 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Ministria e Punëve të Brendshme, ndërsa kjo e fundit me datë 18.07.2025, ka dorëzuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) si prova i administroi: Ankesën me numër protokolli 4437/2025 të datës 01.07.2025 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës;

Konkursin me Nr. Reference: RN00017620, për pozitën e punës “Asistent Administrativ”; Kopjen e ID-së së ankueses; Aneks 9 Letër Reference e datës 30.11.2024; Zarfën e datës 26.06.2025; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 10.07.2025; Përgjigjen në ankesë e datës 18.07.2025; Listën e aplikantëve; Vendimi i datës 21.05.2025 për emërimin e komisionit të pranimit; Njoftimin me numër protokolli 1154 të datës 20.06.2025 për kandidatin fitues; Aplikacioni i ankueses i datës 05.05.2025 me dokumentacionin faqe 1-3; Aplikacionin e kandidates D.F të datës 12.05.2025 me dokumentacionin nga faqe 1-6; Njoftimin e datës 29.05.2025 për verifikim paraprak; Njoftimin e datës 29.05.2025 për refuzimin e aplikacionit të ankueses; Njoftimin e datës 18.06.2025 për rezultatin e testit me shkrim; Testin me shkrim; Formularët e vlerësimit të intervistës me gojë datë 20.06.2025; Lista-Renditja përfundimtare e kandidatëve e datës 20.06.2025.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, konstatoi së ankesa e ankueses **është e pabazuar, sepse:**

Nga administrimi i shkresave të lëndës, Kolegji i Këshillit, ka gjetur se Ministria e Punëve të Brendshme, më datë 14.04.2025 ka shpallur konkursin me Nr. Reference: RN00017620, për Grupin e Administrimit të Përgjithshëm-Arsim i Mesëm, për pozitën e punës “Asistent Administrativ”, në Qendrën e Regjistrimit të Automjeteve në Vushtrri, klasa e pozitës profesional 3, me afat aplikimi nga data 15.04.2025 deri më datë 14.05.2025.

Tutje, nga shkresat e lëndës rezulton se në këtë konkurs kanë aplikuar 125 kandidatë, ndërsa sipas njoftimit të datës 29.05.2025 verifikimin paraprak e kanë kaluar 75 kandidatë, kurse përmes Njoftimit të datës 29.05.2025 të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Punëve të Brendshme, ankueses i është refuzuar aplikacionin për shkak se në aplikacionin e saj i mungon diploma e shkollës së mesëm si kërkesë e konkursit.

Pas përfundimit të procedurës, Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore e Ministrisë së Punëve të Brendshme, më datë 20.06.2025, ka publikuar njoftimin me numër protokolli 1154 për rezultatet përfundimtare me kandidatin me më së shumti pikë D.F me gjithsej 83 pikë.

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshillin e pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se refuzimi i aplikacionit është i padrejtë për shkak që nuk janë dhënë arsye konkrete pse është refuzuar aplikacionit. Kërkon që ankesa të aprovohet dhe të obligohet institucioni të përfshijë në fazat tjera të procedurës.

Kolegji i Këshillit, lidhur me këtë çështje ankimore ka analizuar aktin e shpalljes së kësaj pozite, respektivisht sipas konkursit me Nr. Reference: RN00017620 për Grupin e Administrimit të Përgjithshëm-Arsim i Mesëm, për pozitën e punës “Asistent Administrativ”, dhe ka gjetur se kërkesa të përgjithshme formale në procedurën përkatëse të rekrutimit kanë qenë: **Arsimimi i kërkuar: Diplomë e shkollës së mesme apo ekuivalente me të, në arsimim i mesëm i paspecifikuar. Përvoja e punës nuk kërkohet**, e për rrjedhojë Kolegji vlerëson se konkursi është shpallur sipas kriterëve për grupin e përcaktuar në pajtim me dispozitat e Rregullores (QRK) Nr. 06/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, dhe Katalogun e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil.

Rrjedhimisht, Kolegji lidhur me këtë çështje juridike, ju referuar dispozitave të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht:

- Nenit 9 paragrafi 1, ku përcaktohet se: *1. Kriteret e përgjithshme që një person duhet t'i plotësojë në procedurën e rekrutimit, për t'u pranuar si zyrtar publik në cilëndo kategori apo nivel, janë: 1.1. të jetë shtetasi Republikës së Kosovës; 1.2. të ketë zotësi të plotë veprimi, sipas legjislacionit në fuqi; 1.3. të zotërojë të paktën njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët; 1.4. të jetë e/i aftë për të kryer detyrën përkatëse; 1.5. të mos jetë e/i dënuar për kryerjen e veprës penale me dashje; 1.6. të mos ketë në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik; 1.7. të ketë arsimin, përvojën e punës profesionale dhe/apo aftësitë e kërkuara për pozitën, kategorinë, klasën apo grupin përkatës; dhe 1.8. të kaloj me sukses procedurat e pranimit të përcaktuara në këtë ligj''*,

-nenit 39 paragrafi 1, dhe 7, ku përcaktohet: *1. Pranimi në shërbimin civil bëhet në të gjitha kategoritë e shërbimit civil, nëpërmjet një procedure rekrutuese të hapur dhe publike, përveç kur parashikohet ndryshe me këtë ligj. 7. Konkurrimi zhvillohet në dy (2) faza: 7.1. verifikimi paraprak përmes të cilit verifikohet nëse kandidatët i plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe ato të veçanta, sipas shpalljes së konkursit; dhe 7.2. vlerësimi profesional që përfshin vlerësimin e njohurive dhe cilësive profesionale të kandidatëve.*

Po ashtu Kolegji ju referua, Rregullores (QRK) Nr.15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil, respektivisht nenit 7 paragrafi 1, ku përcaktohet se: *1. Verifikimi paraprak është procesi i verifikimit nëse kandidatët për pranim në shërbimin civil plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe ato të veçanta, sipas shpalljes së konkursit.*

Me qëllim të shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankueses e cila pretendon se pa asnjë arsytim i është refuzuar aplikacioni për pozitën përkatëse, Kolegji i Këshillit, ka konstatuar se sipas Njoftimit të datës 29.05.2025 të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Punëve të Brendshme, ankueses i është refuzuar aplikacionin për shkak se në aplikacionin e saj i mungon diploma e shkollës së mesme si kërkesë e konkursit, e me qëllim të vlerësimit të drejtë të kësaj çështje, Kolegji ka shqyrtuar aplikacionin e ankueses të datës 05.05.2025, dhe ka gjetur se ankuesja me rastin e aplikimit nuk ka bashkangjitur diplomën e shkollës së mesme si kërkesë e konkursit lidhur me arsimimin. Kështu që Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore verifikimin paraprak nëse kandidatët i plotësojnë kriteret e përgjithshme formale e bënë duke u bazuar në kompetencat e dhëna sipas nenit 39 paragrafi 7 nën paragrafi 7.1 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, nenit 7 të Rregullores (QRK) Nr.15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil, ndërsa Njoftimi i Burimeve Njerëzore i Ministrisë së Punëve të Brendshme, për refuzimin e aplikacionit lidhur me konkursin me Nr. Reference RN00017620, është akt i drejtë dhe i ligjshëm i nxjerr në pajtim me kërkesat e përgjithshme për pranim të përcaktuar me nenin 9 paragrafi 1 nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë dhe kërkesave të konkursit dhe i arsyetuar, mbi këtë bazë ankuesja nuk ka plotësuar kërkesat e përgjithshme formale gjegjësisht arsimin e kërkuar sipas konkursit ngase nuk ka dorëzuar diplomën e kërkuar sipas konkursit.

Tutje, Kolegji i Këshillit, në kontest të shqyrtimit të kësaj procedure rekrutimit dhe duke u bazuar në dispozitat e sipër theksuara ligjore, ka analizuar aplikacionin e kandidatit fitues D.F, të datës 12.05.2025, nga i cili rezulton se e njëjta si dëshmi për plotësimin e kriterit arsimor, ka bashkangjitur Diplomën e datës 23.05.2022 të lëshuar nga Gjimnazi "Eqrem Çabej" në Vushtri, më të cilin dëshmohet se ka përfunduar shkollën e mesme, e për rrjedhojë e njëjta ka plotësuar kërkesat e përgjithshme formale të konkursit.

Përkritazi me këtë Kolegji i Këshillit, konstaton se Njoftimi me numër protokolli 1154 të datës 20.06.2025, për kandidatin fitues i Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore i Ministrisë së

Punëve të Brendshme, për pozitën “*Asistent Administrativ*”, është në pajtim të plotë me dispozitat e Rregullores Nr.15/2023 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, përkatësisht nenin 11 paragrafi 1 dhe 2, ku përcaktohet se: *1. Vlerësimi përfundimtar i kandidatit përfshin shumën e pikëve të përfituara në secilin hap të vlerësimit. 2. Pas përfundimit të intervistës, Komisioni i Pranimit përgatit listën përfundimtare të kandidatëve që kanë kaluar pragun prej 70% të pikëve totale që e përcjell te NjMBNj, emrin dhe mbiemrin e kandidatit fitues, si dhe pikët e arritura në testin me shkrim, intervistën dhe pikët e përgjithshme për secilin kandidat.*

Kështu që pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: *Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.1255/2025

Avdyl BEKTESHI

Procesmbajtës

Malsore Gashi BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankueses F.Zh;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në MPB; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.